



## **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NDËRMJET ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK) DHE SHOQATËS SË STOMATOLOGËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (SHSRK)**

### **Neni 1**

Oda e Stomatologëve të Kosovës dhe Shoqata e Stomatologëve të Republikës së Kosovës (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për bashkëpunimin reciprok në fushën e shkëmbimit të informacioneve, përvojave dhe organizimit të përbashkët të aktiviteteve profesionale në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në vazhdim *EVP*), me qëllim të mbështetjes së procesit të avancimit profesional të profesionistëve të stomatologjisë

### **Neni 2**

Palët dakordohen të mbështesin organizimin e aktiviteteve profesionale e shkencore të përbashkëta në fushën e EVP, si: ligjëratë, kongrese/konferenca, tubime shkencore, seminare, simpoziume, trajnime dhe forma tjera të aktiviteteve me qëllim të ngritjes profesionale të stomatologëve në nivel vendi.

### **Neni 3**

OSK merr angazhimin për të njojur dhe për të akredituar format e ndryshme të aktiviteteve në kuadër të EVP e që SHSRK organizon dhe është bartës i tyre

### **Neni 4**

Palët zotohen që me marrëveshje të ndërsjellët t'i ndajnë detyrat dhe obligimet e përgjithshme në rastet kur organizimi i aktiviteteve profesionale e shkencore në kuadër të EVP-së është i përbashkët, Ndarja e shpenzimeve për organizimin e aktiviteteve profesionale e shkencore (ku përfshihen sallat, ligjeruesit e ftuar, drekat dhe darkat për ligjerues të ftuar dhe mysafir të ftuar, tj.) bëhet sipas marrëveshjes paraprake.

### **Neni 5**

Ky memorandum lidhen në afat të pacaktuar. *Palët* mund të bien dakord në çdo kohë përfundimin e këtij memorandumi.

### **Neni 6**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes *Palëve*.

### **Neni**

Ky memorandum është lidhur në gjuhën shqipe dhe atë në 2 (dy) ekzemplar identik, nga 1 (një) për secilën palë dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

**Prishtinë, 02.02.2021**

**Për OSK**

Prof.Dr. Blerim Kamberi  
Kryetar



**Për SHSRK**

Dr.Sc. Donika Bajrami  
Kryetare

